

UDHËZIM
Nr. 15, datë 6.6.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 27.2.2018
“PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE PËR
T’U PUNËSUAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 27.2.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

2. Neni 4, i kreut I, të ndryshojë si më poshtë:

“Në testimin e informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar kanë të drejtë të marrin pjesë individët që janë pranuar në fazën e parë të konkurrimit nëpërmjet vlerësimit të dosjes, sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe të Rinisë (MASR-së).”.

3. Në nenin 7, të kreut II, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “b” shfuqizohet;

b) shkronja “e” ndryshon si vijon:

“e. vënien në dispozicion, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, të funksionit për shpalljen në portal të rezultateve përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve.”.

4. Në nenin 9 të kreut II, shkronjat “d”, “k” dhe “m” ndryshohen si më poshtë:

“d. harton kalendarin e testimit të informatizuar sipas profileve të miratuara nga MASR-ja, pas marrjes në dorëzim të listave të kandidatëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP). Lista e kandidatëve që do t’i nënshtrohen testimit të informatizuar dërgohet 1 (një) javë para fillimit të sesionit të zhvillimit të testeve dhe përmban këto të dhëna: emër, atësi, mbiemër, ID, profili, zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP-të) ku dëshirojnë të konkurrojnë kandidatit.”.

“k. dërgon në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) dhe në DPAP rezultatet e testimit përfundimtar.”.

“m. në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) shqyrton ankimimet për testimin e informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tri ditëve nga shpallja e rezultatit.”.

5. Në nenin 10 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në titullin e nenit 10, si dhe kudo në përmbajtjen e tij, togfjalëshi “njësi arsimore vendore” zëvendësohet me togfjalëshin “Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar”

b) Shkronja “c” dhe “d” ndryshojnë, si më poshtë:

“c. përgatit listën e kandidatëve që janë të kualifikuar në fazën e parë të konkurrimit dhe që do të marrin pjesë në testim, bashkë me pikët e përfutuara dhe e dërgon në DPAP.”.

“d. përgatit listën e kandidatëve që dëshirojnë të mbartin pikët e testimit dhe pikët e dosjeve të konvertuara, të portalit “Mësues për Shqipërinë” të një viti më parë dhe e dërgon në DPAP.”.

6. Në pikën 2, të nenit 11, të kreut II, shtohet pika “f”, si më poshtë:

“f. të jenë të pajisur me formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar, i cili lëshohet nga komisioni i vlerësimit të dosjeve të DRAP-së.”.

7. Neni 13 i kreut II, shfuqizohet.

8. Në nenin 14 të kreut II, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja “a” dhe “b” e pikës 1 ndryshon , si më poshtë:

“a. faza e parë: vlerësimi me pikë nga dokumentet e dosjes së kandidatit.

b. faza e dytë: vlerësimi nga testimi i informatizuar (në masën 80 pikë).”.

b) Pikat 2 dhe 3 ndryshojnë si më poshtë:

“2. Teza e testimit të informatizuar përmban 50 pyetje, përgjigjet e sakta të të cilave vlerësohen me 100 për qind që konvertohen maksimalisht në 80 pikë, sipas tabelës bashkëlidhur.

3. QSHA-ja bën konvertimin e vlerësimit të testimit të informatizuar dhe ua dërgon DPAP-së dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.”

9. Në nenin 15, të kreut III, bëhen ndryshimet si vijon:

a) Pika 2 shfuqizohet.

b) Pika 8 ndryshon si vijon:

“8. Programet orientuese për kandidatët e arsimit special, përgatiten sipas programeve të formimit të përgjithshëm të përgatitur nga ASCAP.”.

10. Neni 17 i kreut III, shfuqizohet.

11. Shkronja “d” e nenit 19, të kreut III, të ndryshojë si më poshtë:

“d. I dorëzon QSHA-së fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse ku saktësohet përgjigja e saktë.”.

12. Pika 1 e nenit 20, të kreut III, të ndryshojë, si më poshtë:

“1. Në ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar duhet të jenë të pranishëm 1–2 përfaqësues nga ASCAP.”.

13. Neni 23, i kreut IV, të ndryshojë, si më poshtë:

“23. Për kandidatët që aplikojnë për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe dëshirojnë të mbartin pikët e testimit të portalit të një viti më parë, QSHA-ja tërbeq nga DPAP-ja pikët e testimit të portalit të një viti më parë dhe bën konvertimin e tyre.”.

14. Kudo në udhëzim, emërtimi Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) zëvendësohet me emërtimin Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).

15. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

Pikë në sistemin me 100 pikë	Sa pikë i korrespondojnë për secilën pikë në sistemin me 80 pikë
1	0.8
2	1.6
3	2.4
4	3.2
5	4
6	4.8
7	5.6
8	6.4
9	7.2
10	8
11	8.8
12	9.6
13	10.4
14	11.2
15	12
16	12.8

17	13.6
18	14.4
19	15.2
20	16
21	16.8
22	17.6
23	18.4
24	19.2
25	20
26	20.8
27	21.6
28	22.4
29	23.2
30	24
31	24.8
32	25.6
33	26.4
34	27.2
35	28
36	28.8
37	29.6
38	30.4
39	31.2
40	32
41	32.8
42	33.6
43	34.4
44	35.2
45	36
46	36.8
47	37.6
48	38.4
49	39.2
50	40
51	40.8
52	41.6
53	42.4
54	43.2
55	44
56	44.8
57	45.6
58	46.4
59	47.2
60	48
61	48.8

62	49.6
63	50.4
64	51.2
65	52
66	52.8
67	53.6
68	54.4
69	55.2
70	56
71	56.8
72	57.6
73	58.4
74	59.2
75	60
76	60.8
77	61.6
78	62.4
79	63.2
80	64
81	64.8
82	65.6
83	66.4
84	67.2
85	68
86	68.8
87	69.6
88	70.4
89	71.2
90	72
91	72.8
92	73.6
93	74.4
94	75.2
95	76
96	76.8
97	77.6
98	78.4
99	79.2
100	80